

## RELACION

### PËR

### AKTIN NORMATIV “PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA NË FUSHËN E VEPRIMTARISË SË SHËRBIMIT PËRMBARIMOR GJYQËSOR, NDËRMJETËSIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË PROCEDURAVE TË FALIMENTIMIT GJATË KOHËZGJATJES SË GJENDJES SË EPIDEMISË SË SHKAKTUAR NGA COVID-19”

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

“Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Masat e marra nga organet përgjegjëse për parandalimin e përhapjes së epidemisë nga njëra anë garantojnë mospërhapjen e epidemisë, por, nga ana tjetër, ndikojnë në veprimtarinë e rregullt gjyqësore dhe të prokurorisë, veçanërisht duke pasur në konsideratë që kjo lloj veprimtarie është e lidhur me kryerjen e veprimeve procedurale brenda afateve të përcaktuara nga legjislati në fuqi.

Kësisoj, në raport edhe me miratimin e këtij akti normativ në fushën e veprimtarisë gjyqësore, duke kufizuar në mënyrë proporcionale me gjendjen e diktuar veprimtarinë e gjykatave në Republikën e Shqipërisë, qëndron lidhja e drejtpërdrejtë me veprimtarinë që kryen shërbimi përmbarimor gjyqësor

shtetëror dhe privat, ndërmjetësit dhe administratorët e falimentimit gjatë procedurave të falimentimit.

Për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me institucionet e tjera, është duke punuar për të marrë masa të veçanta për parandalimin e përhapjes së këtij infeksioni për shkak të zhvillimit të procedurave të ekzekutimit të titujve ekzekutivë, të zhvillimit të veprimtarisë së ndërmjetësve dhe kryerjes së veprimeve procedurale nga administratorët e falimentimit, si dhe, nga ana tjetër, për të garantuar mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetasve që mund të cenohen për shkak të veprimtarisë së shërbimit përmbartimor, ndërmjetësit apo administratorëve në procedurën e falimentimit, duke marrë në konsideratë që veprimtaria gjyqësore është pezulluar gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Akti normativ nuk lidhet me programin politik të Këshillit të Ministrave dhe as me dokumente të tjera politike, por vjen si një domosdoshmëri në përgjigje të një situate ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, me vendimin nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, si dhe në kuadër të masave shtrënguese të gjithanshme, të ndërmarra nga Këshilli i Ministrave për shkak të kësaj pandemie.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Coronavirusi i ri COVID-19 është përhapur në masë të gjerë në të gjithë botën. Për shkak të përhapjes së shpejtë dhe mjediseve të kufizuara për të garantuar distancimin social dhe garantimin e ruajtjes së siguri së dhe shëndetit të të gjitha subjekteve që marrin pjesë në procedurat e ekzekutimit të një titulli ekzekutiv, procedurat e ndërmjetësit apo të falimentimit është e nevojshme të merren masa parandaluese.

Ndër masat që janë marrë nga autoritetet përgjegjëse është edhe pezullimi i veprimtarive në fushën e shërbimit përmbartimor gjyqësor. Konkretisht, Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë ka miratuar udhëzuesin “Mbi funksionimin e veprimtarisë së përmbartuesve gjyqësorë privatë gjatë periudhës së forcës madhore apo rastit faktor pandemia COVID-19”, ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor ka miratuar urdhrin nr.525, datë 11.3.2020, “Për pezullimin e veprimtarisë dhe

shërbimeve në Shërbimin Përbarimor Gjyqësor Shtetëror”, për shkak të situatës së krijuar nga përhapja e infeksionit COVID-19, për një periudhë 2-javore nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

Sidoqoftë, duke qenë që këto masa ndikojnë në veprimtarinë e rregullt të përbaruesve gjyqësorë, veçanërisht duke pasur në konsideratë që kjo lloj veprimtarie është e lidhur me kryerjen e veprimeve procedural e brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, lind nevoja që të përcaktohen rregulla të tjera të posaçme për zhvillimin e veprimtarisë në fushën e shërbimit përbarimor, shtetëror dhe privat, por edhe në atë të ndërmjetësve dhe të administratorëve të falimentit gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë.

Po kështu, me vendosjen e kufizimeve të veprimtarisë së shërbimit përbarimor gjyqësor, shtetëror dhe privat, ndërmjetësi mit dhe procedurave të falimentimit, synohet të zbatohen masat parandaluese, konkretisht shmangia e ambienteve me shumë njerëz, kontaktet e ngushta dhe ruajtja e distancës së sigurisë. Nëpërmjet këtij akti normativ mundësohet vijimi i atyre shërbimeve apo veprimtarive që janë absolutisht të nevojshme, për të shmangur në mënyrën më të madhe të mundshme, kontaktet ndërmjet individëve.

Përpos kësaj, në kushtet kur me aktin normativ nr.9, datë 25.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, janë shtyrë të gjithë seancat gjyqësore për çështjet administrative, civile dhe penale, të planifikuara pranë të gjitha gjykatave si dhe janë pezulluar afatet për ngritjen e padive, paraqitjen e ankimeve si dhe për kryerjen e çdo veprimi procedural në çështjet administrative, civile dhe penale, deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë, është e rëndësishme që të merren masa dhe mekanizma mbrojtës për mbrojtjen e të drejtave ligjore të shtetasve që i janë nënshtruar apo janë pjesë e një procedure ekzekutimi titulli ekzekutiv, ndërmjetësi apo falimentimi dhe ndodhen në kushtet e pamundësisë për shkak të situatës së krijuar për të kërkuar dhe investuar gjykatën, përmes mjeteve të mbrojtjes gjyqësore, në kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të caktuara në një procedurë ekzekutimi të titullit ekzekutiv, ndërmjetësi apo falimentimi.

Këtu qëndron pikërisht qëllimi i këtij akti normativ, i cili ka të bëjë me mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetasve që mund të cenohen për shkak të veprimtarisë së shërbimit përbarimor, shtetëror dhe privat, ndërmjetësi mit apo administratorëve në procedurën e falimentimit, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19.

Në këto kushte, në një situatë të jashtëzakonshme, është e nevojshme që të merren masa të jashtëzakonshme me qëllim garantimin e kushteve të përshtatshme për parandalimin e përhapjes së coronavirusit, nëpërmjet përcaktimit të rregullave për kryerjen e veprimtarisë së shërbimit përbarimor

gjyqësor, shtetëror dhe privat, ndërmjetësimit dhe administrimit të procedurave të falimentimit deri në përfundimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Sidoqoftë, duke pasur në konsideratë, që për një numër çështjesh për shkak të nevojës për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve, ndaj të cilëve ekziston mundësia e shkaktimit të një dëmi të rëndë e të parikuperueshëm, është e nevojshme që, pavarësisht gjendjes së epidemisë, përjashtimisht të lejohet ushtrimi i veprimtarisë, si më poshtë:

- Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë që rrjedhin nga çështje familjare, me objekt kujdesin, detyrimet dhe respektimin e të drejtave të të miturve, kujdestarinë, birësimin, ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, përkujdesjen dhe detyrimet për ushqim;
- Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, me objekt urdhrat e mbrojtjes dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes;
- Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, me objekt masat e sigurimit të padisë për çështje administrative dhe në të gjitha çështjet civile si dhe për kryerjen e veprimeve procedurale nga administratorët e falimentimit, në të cilat gjykata çmon se nga vonesa e ekzekutimit ose e kryerjes së veprimeve procedurale mund të bëhet i pamundur ekzekutimi i vendimit pas përfundimit të gjendjes së epidemisë apo për të shmangur dëmtimin e masës së falimentimit.
- Nëse është e domosdoshme shmangia e dëmtimit të masës së falimentimit;
- Për ndërmjetësimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën penale, kur gjatë hetimit vlerësohet si e nevojshme për mbrojtjen e interesave të të miturit.

Rregullat dhe përjashtimet, sipas këtij akti normativ, konsiderohen si masa të veçanta për shkak të pandemisë së shkaktuar nga coronavirusi COVID-19 dhe do të jenë të zbatueshme nga organet përgjegjëse për procedurat e ekzekutimit të titujve ekzekutivë, ndërmjetësimit dhe falimentimit.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Kjo nis më mbështetet në nenin 101 të Kushtetutës, që i njeht të drejtën Këshillit të Ministrave që, në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit për marrjen e masave të përkohshme.

Gjykata Kushtetuese, në rastet e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së akteve normative, ka konsideruar se e drejta e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte normative me fuqinë e ligjit, sipas parashikimeve të nenit 101 të Kushtetutës, përbën një përjashtim nga parimi kushtetues i njohjes dhe

përqendrimin të pushtetit ligjvënës në duart e Kuvendit të Shqipërisë, duke lejuar nxjerrjen e akteve me fuqinë e ligjit edhe nga organe të tjera kushtetuese.

Kjo e drejtë ka natyrë lejuese dhe përjashtimore, prandaj Kushtetuta, nëpërmjet nenit 101 të saj, i ka njohur të drejtën Këshillit të Ministrave të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit vetëm kur rasti shfaqet si i jashtëzakonshëm dhe nevoja e urgjencës bëjnë të pamundur ushtrimin e kompetencës ligjvënëse nga Kuvendi. Nevoja dhe urgjenca janë rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Ato mund të shkaktohen nga faktorë të ndryshëm jetësorë, natyrorë e shoqërorë, si fatkeqësitë natyrore, boshllëku legjislativ i shkaktuar nga shfuqizimi i akteve, nevoja për efekte të menjëhershme në fusha me ndjeshmëri të madhe publike, parandalimi i menjëhershëm i spekulimeve. Ajo që i bashkon të gjitha këto situata është fakti se përfaqësojnë një gjendje jo të zakonshme në jetën e vendit, ku evidentohet dukshëm rreziku i ardhjes së pasojave të dëmshme për interesat publike ose për të drejtat themelore të shtetasve. Ky rrezik dikton nevojën e masave të menjëhershme, por që legjislati ekzistues nuk i mundëson dot.

Në përputhje edhe me praktikën e Gjykatës Kushtetuese, gjendja e epidemisë së shkaktuar nga përhapja në masë e coronavirusit, e cila ka pasqyruar shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë me vendimin nr.243, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, jo vetëm që ka pamundësuar funksionimin e rregullt të Kuvendit, për shkak se si pasojë e kësaj epidemie, Kuvendi ka pezulluar punimet e tij, por edhe në kushtet kur Kuvendi mund të ishte duke funksionuar, mosmiratimi i shpejtë i kësaj nisme mund të sjellë ardhjen e pasojave të dëmshme për të gjithë individët në kuadër të sigurisë së tyre, por edhe mbrojtjes të të drejtave në kushtet kur është pezulluar veprimtaria e gjykatave dhe prokurorisë.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTET NORMATIVE)**

Ky akt normativ nuk synon përaftrimin me legjislativin komunitar, ndaj edhe nuk ka vlerësim të shkallës së përaftrimit.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTIT**

Akti normativ përmban 4 nene.

Në nenin 1 parashikohet objekti i aktit normativ, i cili është përcaktimi i masave të veçanta për kryerjen e veprimtarisë së shërbimit përbarimor gjyqësor, shtetëror dhe privat, ndërmjetësimin dhe administrimin të procedurave të falimentimit gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Neni 2 jep qëllimin e këtij akti normativ, që konsiston në mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetasve që mund të cenohen për shkak të veprimtarisë së shërbimit përbarimor shtetëror dhe privat, ndërmjetësve apo administratorëve në procedurën e falimentimit gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19. Në këtë mënyrë, në kushtet kur gjykatat kanë pezulluar veprimtaritë e tyre, shtetasit mund të cenohen në interesat e tyre nga veprimtaria e përbaruesve, ndërmjetësve dhe administratorëve të falimentimit dhe të mos kenë një mjet efektiv ankimi ndaj kësaj veprimtarie. Për këtë qëllim, ky akt normativ parashikon pezullimin e afateve përkatëse, me qëllim që shtetasit të mund të ushtrojnë të drejtën e ankimit në gjykatë, pëkundrejt veprimtarisë së këtyre shërbimeve të lidhura me sistemin gjyqësor.

Në nenin 3 janë përcaktuar masat e veçanta që ndërmerren në fushën e shërbimit përbarimor gjyqësor, ndërmjetësimit dhe falimentimit, për shkak të arsyeve të sipërpërmendura, si pasojë e epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19.

Nga data e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19 pezullohen afatet për kryerjen e veprimeve procedurale nga përbaruesit gjyqësorë ose shoqëritë përbarimore private, ndërmjetësit dhe administratorët në procedurat e falimentimit. Kur afatet për kryerjen e veprimeve procedurale sipas parashikimit të legjislacionit në fuqi fillojnë gjatë periudhës së pezullimit, ato shtyhen deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë.

Në pikën 2, të këtij neni, janë dhënë edhe rastet përjashtimore, për të cilat është i nevojshëm ushtrimi i veprimtarisë nga organet përkatëse, pavarësisht gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Rastet janë përcaktuar përgjithësisht në të njëjtën linjë me përjashtimet e vendosura në pikën 3, të nenit 3, të aktit normativ nr.9, datë 25.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore, gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Kësisoj, rregulli i përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, nuk zbatohet në rastet vijuese:

- Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë që rrjedhin nga çështje familjare, me objekt kujdesin, detyrimet dhe respektimin e të drejtave të të miturve, kujdestarinë, birësimin, ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, përkujdesjen dhe detyrimet për ushqim;
- Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, me objekt urdhrat e mbrojtjes dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes;

- Për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, me objekt masat e sigurimit të padisë për çështje administrative, si dhe për çështjet civile, në të cilat gjykata ka dhënë vendim për sigurimin e padisë ose vendim me ekzekutim të përkohshëm, kur nga vonesa e ekzekutimit ose e kryerjes së veprimeve procedurale, bëhet i pamundur ekzekutimi i këtyre titujve ekzekutiv, pas përfundimit të gjendjes së epidemisë;
- Nëse është e domosdoshme shmangia e dëmtimit të masës së falimentimit;
- Për ndërmjetësimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën penale, kur gjatë hetimit vlerësohet si e nevojshme për mbrojtjen e interesave të të miturit.

Pika 3, e këtij neni, përcakton se gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga përhapja e COVID-19 në funksion të zbatimit të rregullave nënligjore të nxjerra nga organet përgjegjëse shtetërore, organet e shërbimit përmbartimor shtetëror dhe privat, të ndërmjetësve dhe administratorëve të falimentimit, në të gjitha rastet, marrin masa organizative të posaçme për të shmangur grumbullimet, kontaktet e ngushta ndërmjet individëve, si dhe praninë e publikut në ambientet e ushtrimit të aktivitetit të përmbartuesit gjyqësor, ndërmjetësit dhe administratorit të falimentimit.

Në nenin 4 parashikohet hyrja në fuqi menjëherë e këtij akti normativ dhe botimi në “Fletoren zyrtare”.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT**

Për zbatim e këtij akti normativ ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit, Dhoma Kombëtare e Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë, përmbartuesit gjyqësorë shtetërorë dhe privatë, shoqëritë përmbartimore, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësimit, ndërmjetësit dhe Agjencia Kombëtare e Falimentit.

## **VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Akti normativ është hartuar nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Akti normativ i propozuar nuk shoqërohet me efekte financiare për buxhetin e shtetit.

**KËSHILLI I MINISTRAVE**

[Shqiptaria.com]